



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministarstvo Rada / Социалне Заштита - Ministry of Labour and Social Welfare Sektor i Arkivit / Sektor Arkiva - Archive Sector	
Kësia Org Org. Unit No. i Dokumentit No. i Dokumentit	Nr. Prot: Broj Prot: 2539 Prot. No: Data: Datum: 12.05.2016 Date: Prishtinë - Priština - Priština

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

KONTRATA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

D.P.H "IN" Rr. Luan Haradinaj, 17/1, Prishinë (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

" Shërbimet e buffe-së në ndërtesën e MPMS-së" me numër Identifikues *MPMS/209/016/006/236*.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimet e buffe-së në ndërtesën e MPMS-së, Furnizimi dhe shërbimi me lëngje pemësh në shishe të qelqit 200 ml (copë 2400), lëngje në shishe të qelqit 250 ml (copë 3360), lëngje në kanaqe 300 ml (copë 1320), ujë ' 500 ml(copë 5400), ujë , në shishe të qelqit 250 ml (copë 1800), çaj të ngrohtë ,'(copë 3600), kafe „Espresso” (copë 2400), Makiato të madhe (copë 1800), Makiato të vogël (copë 2520), Latte Makiato (copë 1920), Ness kafe (copë 2400), kafe turke të madhe(copë 720), kafe turke të vogël(copë 840), kafe kampuqino(copë 840) Sasia e përafërt vjetore, referuar në specifikacionin tenderik të bashkangjitur me kontratë.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datë 27.05.2016 dhe përfundon me datën 27.05.2017 .

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj nga data e marrjes së urdhresës.

1.4 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] kryerjes së shërbimeve do të jetë: Operatori ekonomik do të ofroj shërbime të pijeve të ftofta dhe të nxehta brenda ndërtesës së MPMS-së

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 7,978.80€; (*shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent*)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno] më shumë se një dërgesë
Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* shërbimeve *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* *[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* *[të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* *[punëve]* shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në

mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata Ekonomike e Prishtinës** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues është nga DFSHP- Kushtrim Gashi për menaxhimin e Kontratës si dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqip** [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	SHABAN ALIJA	Emri:	Feti Ibishi
Pozita:	PROKUR	Pozita:	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit- MPMS
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	12.05.2016	Data:	12.05.2016
Vula:		Vula:	



Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia e përfaqër vjetore	Çmimi njësi Pa TVSH - €	TVSH (%)	ÇMIMI NJËSI ME TVSH €	Çmimi total me TVSH €	Koha e dërgesës
1.	Furnizimi dhe shërbimi me lëngë pemësh ne shishe te qelqit 200 ml	copë	2400	0,38	0,07	0,45	1080	
2.	Furnizimi dhe shërbimi me lëngje në shishe të qelqit 250 ml	copë	3360	0,25	0,05	0,30	1008	
3.	Furnizimi dhe shërbimi me lëngje në kanaqe 300 ml	copë	1320	0,42	0,08	0,50	660	
4.	Furnizimi dhe shërbimi me ujë ' 500 ml	copë	5400	0,21	0,04	0,25	1350	
5.	Furnizimi dhe shërbimi me ujë '' ne shishe te qelqit 250 ml	copë	1800	0,25	0,05	0,30	540	
6.	Furnizimi dhe shërbimi me çaj të ngrohtë ,	copë	3600	0,08	0,02	0,10	360	
7.	Furnizimi dhe shërbimi me kafe „Espresso“	copë	2400	0,24	0,05	0,29	696	
8.	Furnizimi dhe shërbimi me Makiato te madhe	copë	1800	0,33	0,07	0,40	720	
9.	Furnizimi dhe shërbimi me Makiato te vogël	copë	2520	0,24	0,05	0,29	730,80	
10.	Furnizimi dhe shërbimi me Latte Makiato	copë	1920	0,08	0,02	0,10	192	

11.	Furnizimi dhe shërbimi me Ness kafe	copë	2400	0,17	0,03	0,20	480
12.	Furnizimi dhe shërbimi me kafe turke te madhe	copë	720	0,04	0,01	0,05	36
13.	Furnizimi dhe shërbimi me kafe turke te vogël	copë	840	0,04	0,01	0,05	42
14.	Furnizim me kafe kampuqino	copë	840	0,08	0,02	0,10	84
Totali i Përgjithshëm:							7.978,80

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	DPH. IN
ADRESA E PLOTE	LUAN HARADINAJ 17/1 10000 PRISHTINË
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	SHABAN ALIJA
POZITA	PRONAR
NËNSHKRIMI	Senen
DATA	29.04.2016
VULLA	



per: OE
OE:

Arxhi DELIĆ

Senen

D.P.H. PART-2H.